VENDIM
Nr. 538, datë 13.9.2023

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË ZBATIMIT PËR PROJEKTE TË BASHKËPUNIMIT TEKNIK NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL, DHE *DEUTSCHE GESELLSCHAFT FÜR INTERNATIONALE ZUSAMMENARBEIT (GIZ) GMBH*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 22, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së zbatimit për projekte të bashkëpunimit teknik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, dhe *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH*, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Marrëveshje Zbatimi për Projekte të Bashkëpunimit Teknik

Përmbajtja

Baza e marrëveshjes

1. **Objektivi i projektit**
2. **Kontributet e GIZ-it**
   Vënia në dispozicion e ekspertëve
   Furnizimi i materialeve dhe pajisjeve
   Kostot operacionale dhe administrative
   Kontribute të tjera
3. **Kontributet e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**
   Vënia në dispozicion e ekspertëve dhe personelit ndihmës
   Kostot
   Vënia në dispozicion e zonave, ndërtesave dhe vendeve të punës
4. **Dispozita të tjera**
   Vlerësimi
   Pezullimi i kontributeve dhe ndërprerja e marrëveshjes
   Afati i marrëveshjes
   Përshtatja e marrëveshjes
   Forma e shkruar
   Marrëveshjet me organizatat individuale zbatuese
   Zbatimi i marrëveshjes
   Zgjidhja e mosmarrëveshjeve
   Hyrja në fuqi, kopjet

MARRËVESHJE ZBATIMI

ndërmjet

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë
të përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Adresa :
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr.2, Tiranë

-në vijim e referuar si MBZHR-

dhe

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH
Dag-Hammarskjöld-Weg 1-5
65760 Eschborn

-në vijim e referuar si "GIZ" -

në lidhje me projektin

Zhvillimi i Qëndrueshëm i Zonave Rurale në Shqipëri 2 (ZHQZR 2)

-në vijim i referuar si "Projekti" –

Baza e marrëveshjes

Sa më poshtë vijon do të përbëjë bazën e kësaj Marrëveshjeje:

- Marrëveshja për Bashkëpunimin Teknik, lidhur ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Shqipërisë, datë 21 tetor 1988, (shihni Shtojcën 1).

- Nota Verbale 294/2017 e datës 23 nëntor 2017 e Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë mbi alokimin e fondeve për projektin "Zhvillimi i qëndrueshëm i zonave rurale" (Shtojca 2).

- Procesverbali Përmbledhës i negociatave lidhur me Bashkëpunimin për Zhvillim ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Shqipërisë, datë 12 dhjetor 2017 (Shtojca 3).

- Procesverbali Përmbledhës i Negociatave për Bashkëpunimin Zhvillimor ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Shqipërisë më 22 nëntor 2018 (Shtojca 4).

- Nota Verbale 314/2018 e datës 30 nëntor 2018 e Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë që i referohet Procesverbalit Përmbledhës të Negociatave për Bashkëpunimin Zhvillimor ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Shqipërisë, datë 22 nëntor 2018 (Shtojca 5).

- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë lidhur me fondet e vitit 2017, për Projektin "Zhvillimi i Qëndrueshëm i Zonave Rurale", datë 27 dhjetor 2018 (Shtojca 6).

- Ligji nr. 19/2019 për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë për Projektin "Zhvillimi i Qëndrueshëm i Zonave Rurale në Shqipëri", të miratuar nga Parlamenti i Shqipërisë, datë 21/03/2019 (shihni Shtojcën 7).

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.41, datë 22.01.2020 "Për marrëveshjen në parim të ndryshimit të Marrëveshjes, me shkëmbim të Notave Verbale, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë, për Bashkëpunimin Teknik 2017, për projektin "Zhvillimi i Qëndrueshëm i Zonave Rurale në Shqipëri".

- Nota Verbale 146 / 2020 e datës 28 korrik 2020 e Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë për plotësimin e projektit ekzistues "Zhvillimi i qëndrueshëm i zonave rurale" (shihni Shtojcën 8) që i referohet Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Republikës Federale të Gjermanisë. Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Projektin "Zhvillimi i Qëndrueshëm i Zonave Rurale", datë 27 dhjetor 2018 (shihni Shtojcën 6). Kjo Marrëveshje përcakton se përfshin çdo shtesë të mëtejshme fondesh nga Qeveria Gjermane.

- Procesverbali Përmbledhës i Negociatave për Bashkëpunimin Zhvillimor ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Shqipërisë, datë 24 nëntor 2020 (shihni Shtojcën 9).

- Nota Verbale 38 / 2021 e datës 17 shkurt 2021 e Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë për plotësimin e projektit ekzistues "Zhvillimi i qëndrueshëm i zonave rurale" (shihni Shtojcën 10) që i referohet Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Projektin "Zhvillimi i Qëndrueshëm i Zonave Rurale", datë 27 dhjetor 2018 (shihni Shtojcën 6). Kjo Marrëveshje përcakton se përfshin çdo shtesë të mëtejshme të fondeve nga Qeveria Gjermane.

- Nota Verbale 60 / 2021 e datës 26 mars 2021 e Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë për plotësimin e projektit ekzistues "Zhvillimi i qëndrueshëm i zonave rurale" (shihni Shtojcën 11) që i referohet Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Projektin "Zhvillimi i Qëndrueshëm i Zonave Rurale" datë 27 dhjetor 2018 (Shtojca 6) dhe duke iu referuar fondeve shtesë sipas shënimit verbal 38/2021 (shihni Shtojcën 10). Kjo Marrëveshje përcakton se përfshin çdo plotësim të mëtejshëm të fondeve nga Qeveria Gjermane.

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.703, datë 18.11.2021 "Për miratimin, në parim, të marrëveshjes ndryshuese, me shkëmbim letrash, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin teknik 2017, për projektin "Zhvillim i Qëndrueshëm i Zonave Rurale", ratifikuar me ligjin nr.19/2019".

- Nota Verbale 181/2022 e datës 31.08. 2022 e Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë për plotësimin **dhe zgjerimin** e projektit ekzistues "Zhvillimi i Qëndrueshëm i Zonave Rurale" (shihni Shtojcën 12) që i referohet Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Projektin "Zhvillimi i Qëndrueshëm i Zonave Rurale" datë 27 dhjetor 2018 (shihni Shtojcën 6) dhe duke iu referuar fondeve shtesë sipas Notës Verbale 38 /2021 (Shihni Shtojcën 10). Kjo Marrëveshje përcakton se përfshin çdo shtesë të mëtejshme të fondeve nga Qeveria Gjermane.

- Procesverbali Përmbledhës i Negociatave për Bashkëpunimin Zhvillimor ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Shqipërisë, datë 13 dhjetor 2022 (Shtojca 13).

- 1. Objektivi i projektit

Objektivi i këtij Projekti është të arrijë një transformim ekonomik të zonave rurale në Shqipëri, i cili është i vlefshëm për popullsinë vendase, duke përfshirë të kthyerit nga emigracioni. Plani i përditësuar i operacioneve do të përcaktohet dhe bihet dakord ndërmjet palëve pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje dhe do të miratohet çdo vit në mbledhjen e Komitetit Drejtues.

GIZ dhe MBZHR janë të angazhuar bashkërisht për këtë objektiv. Objektivi matet nga treguesit e mëposhtëm (rezultatet):

1. 5,105 persona, duke përfshirë 1,170 gra, 1,635 të rinj dhe 370 të kthyer kanë përmirësuar situatën e tyre të punësimit.
2. 3600 Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme, 900 prej të cilave drejtohen nga të rinjtë dhe 360 nga të kthyerit nga emigrimi, kanë treguar se MSME-të kanë investuar në konkurrencën e tyre.
3. Nga ministritë përkatëse janë miratuar 10 rekomandime të politikave kombëtare të bazuara në fakte për transformimin e tregut të zonave rurale ose për afrimin me BE-në.

Fushat e ndërhyrjes ("Rezultatet") përfshijnë:

1) Produkti 1 synon të provojë aftësinë e inovacioneve të përzgjedhura për t'u zbatuar në sektorin agro-ushqimor si dhe në turizmin rural. Supozimi është se NVM-të (përfshirë fermerët e vegjël) mund të aplikojnë inovacione të realizueshme, duke rritur kështu konkurrencën e tyre, duke hapur tregje fitimprurëse dhe duke e vendosur transformimin ekonomik me vlerë për popullsinë vendase.

2) Produkti 2 synon të shkallëzojë inovacionet ekonomikisht të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme mjedisore. Bashkëpunimi ndërmjet aktorëve privatë dhe publikë në rrjetet e inovacionit (partneritete me shumë palë të interesuara) mund të motivojë një numër të konsiderueshëm NVM-sh për të investuar në inovacion (shkallëzim) për të kontribuar në krijimin e të ardhurave dhe vendeve të punës.

3) Produkti 3 synon të garantojë që modelet e vendimeve strategjike për krijimin e klimës së biznesit në zonat rurale, janë të bazuara në prova. Vendimet strategjike të politikave duhet të krijojnë një klimë të favorshme biznesi, e cila duhet të bazohet në të dhëna të besueshme dhe ligjërim të informuar (dialog publik-privat) në mënyrë që të promovojë zhvillimin e NVM-ve dhe krijimin e të ardhurave dhe vendeve të punës.

4) Produkti 4 synon të mbështesë bizneset për të zbutur efektet ekonomike të Pandemisë Covid-19: me një strukturë këshillimore të referuar si "CoSolve-19" NMVM-të në bujqësi, turizëm dhe sektorë të tjerë mbështeten me një kombinim shërbimesh këshillimore dhe këshillimi për nivelin e shoqërive dhe grantet. CoSolve-19 zbatohet së bashku me projektin ProSEED të financuar nga BMZ-ja. Grantet do të menaxhohen nga SRD-ja ndërsa shumica e kontratave të ekspertëve për shërbimet këshillimore menaxhohen nga ProSEED. Një strukturë e përbashkët drejtuese me ministritë partnere të dy projekteve do të sigurojë zbatimin e qëndrueshëm të CoSolve-19.

Një ndryshim i objektivit ose fushave të ndërhyrjes është gjithmonë objekt i miratimit nga Qeveria Gjermane.

Kohëzgjatja totale e Projektit, duke marrë parasysh ndryshimin e buxhetit në dispozicion ,do të jetë 3 vjet (2023-2025).
Treguesit për totalin e projektit janë përcaktuar në komisionin e BMZ-së. Çdo ndryshim, teknik apo financiar do të zyrtarizohet nëpërmjet një marrëveshjeje ndërmjet Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Projekti do të zbatohet së bashku me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) si dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) si partnerët kryesorë të Projektit. Në varësi të aktiviteteve në përputhje me objektivin e Projektit, SRD-ja mund të përfshijë agjenci të tjera si partnerë të drejtpërdrejtë të Projektit.

GIZ dhe MBZHR do të krijojnë dhe mbajnë strukturën drejtuese dhe zbatuese të mëposhtme për kohëzgjatjen e Projektit:

Emri	Përfaqësimi	Roli	Shpeshtësia
Komiteti Drejtues	Ministër ose Zëvendës Ministër MBZHR dhe MTM, Pikat Fokale të MBZHR-së dhe MTM-së, menaxher i programit të GIZ-it, menaxherë të komponentëve të GIZ-it. Përfaqësues nga Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC)	Udhëzimi strategjik, miratimi i planit vjetor të operacioneve, monitorimi i performancës	Vjetore (T1), sipas kërkesës
Ekipi Koordinues	Pikat Fokale në MBZHR / MTM, programet e GIZ-it dhe menaxherët e komponentëve	Koordinimi i përgjithshëm i programit	Në vazhdim
Grupet Teknike të Punës	Kabineti dhe stafi teknik dhe Pika Fokale e MBZHR-së/MTM-së, Ekipi i GIZ-it	Planifikimi i detajuar, teknik dhe zbatimi i paketave të aktiviteteve sipas planit operacional	Në vazhdim

Komiteti Drejtues:

- Do të krijohet me fillimin e projektit të ndryshuar me funksione, detyra dhe anëtarësi të qarta;
- Merr vendime për çështjet strategjike të Projektit dhe miraton planin vjetor të zbatimit;
- Monitoron performancën e Projektit;
- Mblidhet në tremujorin e parë të çdo viti dhe sa herë është e nevojshme.

Për lehtësimin e CoSolve-19, një Strukturë Drejtuese e veçantë është përcaktuar së bashku me ministritë përkatëse partnere dhe duke përfshirë të dy projektet e GIZ-it (SRD dhe ProSEED).

Komunikimi dhe raportimi:

Të dyja palët synojnë të mbajnë njëra-tjetrën të përditësuara me zhvillimet më të fundit të aktiviteteve të programit, sektorët, ministritë, qeveria në përgjithësi, agjencitë shtetërore, donatorët dhe zbatuesit

Raportet përfundimtare të ekspertëve shpërndahen vazhdimisht në Grupet Teknike të Punës.

2. Kontributet në Projekt nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë nëpërmjet GIZ-it

Në përputhje me Notën Verbale 181/2022 të datës 31.08.2022, Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë do t'i sigurojë GIZ-it deri në 7,5 milionë Euro (me fjalë, shtatë milionë e pesëqind mije Euro) për kontributin gjerman midis periudhës 2023 dhe 2025. Kjo shumë do të përfshijë kostot e shkaktuara nga Organizata Zbatuese Gjermane.

2.1 Vënia në dispozicion e ekspertëve

GIZ do të vërë në dispozicion për Projektin:

- një ekspert të kontraktuar si menaxher programi që do të jetë përgjegjës për kontributin e GIZ-it dhe i cili në të njëjtën kohë do të jetë drejtues i ekipit të ekspertëve të vënë në dispozicion për këtë Projekt për kohëzgjatjen e Projektit të përshkruar në Klauzolën 4 më poshtë,

- ekspertët e mëposhtëm:
-- një ekspert i kontraktuar për bujqësinë për kohëzgjatjen e Projektit;
-- një ekspert kombëtar për turizmin rural për kohëzgjatjen e Projektit;
-- deri në tetë ekspertë kombëtarë për bujqësinë dhe turizmin rural për kohëzgjatjen e Projektit;
-- nënkontraktimi i ekspertëve ndërkombëtarë dhe kombëtarë sipas nevojave;

Periudha e dërgimit të ekspertëve të kontraktuar do të përfshijë edhe lejen vjetore në përputhje me dispozitat e ligjit gjerman.

2.2 Furnizimi me materiale dhe pajisje

GIZ do të furnizojë artikujt e mëposhtëm për pajisjen me infrastrukturë teknike:

- orendi, pajisje teknike dhe materiale të tjera të nevojshme brenda objektit dhe gjatë afatit të zbatimit të Projektit;

2.3 Kostot operative dhe administrative

GIZ do të mbulojë kostot operative dhe/ ose administrative që lidhen me procesin e kontributit gjerman në projekt.

2.4 Kontribute të tjera

GIZ mund të japë kontribut financiar për një organizatë. Detajet e këtij kontributi financiar do të përcaktohen në një marrëveshje financimi ndërmjet GIZ-it dhe marrësit të kontributit financiar.
GIZ mund të ofrojë subvencione lokale për një organizatë lokale dhe NVM-të. Detajet e këtyre subvencioneve vendore do të përcaktohen në një marrëveshje ndërmjet GIZ-it dhe përfituesit të subvencionit vendor.

3. Kontributet nga MBZHR-ja

3.1 Vënia në dispozicion e ekspertëve dhe personelit ndihmës

MBZHR-ja do të vërë në dispozicion kontributet e mëposhtme shtesë:

- të garantojë përfaqësimin e duhur të organizatës së tyre në strukturat drejtuese dhe zbatuese të Projektit;
- të sigurojë një pikë të kualifikuar kontakti për të drejtuar projektin e përgjithshëm në palën shqiptare;
- të ofrojë ekspertë të brendshëm teknikë nga Drejtoritë përkatëse të MBZHR-së në përputhje me nevojat e Projektit për të marrë pjesë dhe konceptuar aktivitetet e projektit;

3.2 Kostot

Referuar ndryshimeve të pritshme në ligjin nr. 92/2014 " Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ku parashikohet që për projektet e financuara me fonde të marra në bazë të një marrëveshje donacioni/granti, të lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe donatorëve të huaj, të përjashtohen nga aplikimi i TVSH-së.

MBZHR do të:

- përballojë të gjithë TVSH-në për aktivitetet e projektit dhe shpenzimet e lidhura me to, të kryera në Shqipëri (kostot rrjedhëse dhe prokurimet), si dhe për prokurimet/importet ndërkombëtare dhe të sigurojë buxhetim të mjaftueshëm në kohën e duhur.
- rimbursojë TVSH-në e vlefshme për të gjithë periudhën e zbatimit të projektit, në datën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë (shtojca 5).

Shuma totale e TVSH-së e parashikuar për rimbursim për implementimin e 7.5 milionë Euro është afërsisht 1.5 milion Euro.

Për rimbursimin e TVSH-së, GIZ duhet të dorëzojë dokumentet që vërtetojnë furnizimin e mallrave, shërbimeve ose importeve që i përkasin periudhës nga data e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë gjatë kohëzgjatjes së projektit.

Raportet financiare duhet të dërgohen në mënyrë elektronike në pikën fokale për rimbursimet e TVSH-së dhe monitorimin e brendshëm të buxhetit të MBZHR-së në përputhje me autorizimin e GIZ-it nga BMZ-ja:

- buxheti total i shpenzimeve për vitin e ardhshëm, duke përfshirë pjesën e TVSH-së (vjetore, në janar) dhe për produktet e vitit të kaluar (vjetor, në mars).
- Kërkesa për rimbursim të TVSH-së në intervale të rregullta, duke përfshirë listën e detajuar të faturave dhe aktivitetet treguese, dhe të ndara sipas përgjegjësive ministrore (MARD ose MT). Rimbursimi i TVSH-së nga MBZHR-ja për shpenzimet e shkaktuara në kuadër të aktiviteteve të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, do të kryhet duke marrë në konsideratë konfirmimin e institucionit përkatës mbi furnizimin e mallrave apo shërbimeve të dorëzuara.

3.3 Vënia në dispozicion e zonave, ndërtesave dhe ambienteve të punës

MBZHR-ja do të vendosë në dispozicion të Projektit pa pagesë vendet dhe ndërtesat e mëposhtme, duke përfshirë pajisjet dhe orenditë, në masën që këto pajisje dhe orendi nuk ofrohen nga GIZ-i:

- një ambient zyre në ambientet e MBZHR-së që do të përdoret nga ekspertët e Projektit GIZ, duke përfshirë edhe pastrimin.
- atriumi i godinës së MBZHR-së për evente të përbashkëta.

4. Dispozita të tjera

4.1 Vlerësimi

GIZ-i mund të kryejë një vlerësim të projektit gjatë ose pas zbatimit të kësaj marrëveshjeje. Për këtë, GIZ-i do të caktojë ekspertë të emëruar nga shteti/vlerësues të projektit. MBZHR-ja dhe MTM-ja do të bashkëpunojnë gjatë këtij vlerësimi. MBHZR-ja do të ndihmojë në çdo rast ekspertin(-ët)/vlerësuesin(-sit) dhe do t'i lejojë ata të shqyrtojnë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.

MBZHR-ja do të informohet lidhur me rezultatet e këtij vlerësimi me anë të një raporti.

4.2 Pezullimi i kontributeve dhe ndërprerja e Marrëveshjes

GIZ-i mund të pezullojë kontributet e tij, në rast se:

- MBZHR-ja nuk do të plotësojë detyrimet e saj që rrjedhin nga kjo Marrëveshje ose nga masat lidhur me këtë marrëveshje, ose

- rrethanat janë të tilla që përjashtojnë ose vënë në rrezik të konsiderueshëm objektivin e projektit, siç përshkruhet në Klauzolën 1 më sipër.

Nëse një nga rrethanat e përshkruara në fjalinë 1 më sipër, lind dhe ekziston ende pas një afati kohor për t'u rënë dakord nga GIZ me MBZHR-në ose nëse nuk eliminohet brenda kësaj periudhe, GIZ , me pëlqimin e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, mund të ndërpresë para kohe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

4.3 Afati i Marrëveshjes

Përveç siç parashikohet në Klauzolën 4 më sipër për pezullimin e kontributeve dhe përfundimin e Marrëveshjes, kjo Marrëveshje do të jetë e vlefshme për kohëzgjatjen e fazës në vazhdim të Projektit (aktualisht e planifikuar të zgjasë nga 1 janari 2023 deri më 31 dhjetor 2025). Ajo do të jetë e vlefshme për 6 muaj të tjerë pas përfundimit të projektit për qëllime të raportimit financiar. Afati i kësaj Marrëveshjeje mund të zgjatet në rast të një vonese në ekzekutimin e kontributit gjerman, siç përcaktohet në këtë Marrëveshje dhe në ekzekutimin e kontributeve të rëna dakord të MBZHR-së.

4.4 Përshtatja e marrëveshjes

Në rast se dispozitat e kësaj marrëveshjeje nuk arrijnë të plotësojnë zbatimin efikas të objektivit të përcaktuar në Klauzolën 1 më sipër, atëherë GIZ-i dhe MBZHR-ja mund të përshtatin ose të ndryshojnë këto dispozita me pëlqimin e të dyja palëve në çdo fazë gjatë zbatimit të projektit. Çdo ndryshim do të bëhet me shkrim.

GIZ-i mund ta ndërpresë këtë Marrëveshje në mënyrë të njëanshme, nëse autorizimi që i është dhënë nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, tërhiqet.

4.5 Forma e shkruar

Ndryshimet dhe shtesat e kësaj marrëveshjeje dhe çdo deklaratë tjetër e rëndësishme dhe komunikim i rëndësishëm për ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje, do të bëhet me shkrim. Në rastin e deklaratave dhe komunikimeve për GIZ-in, do të jetë e mjaftueshme që të merren nga drejtuesi i ekipit të ekspertëve të caktuar.

4.6 Marrëveshjet me organizatat individuale zbatuese

Personi përgjegjës për kontributet nga ana e GIZ-it dhe personi(-at) përgjegjës për kontributet nga organizata partnere apo organizatat e tjera zbatuese mund të lidhin së bashku një marrëveshje detyruese mbi detaje shtesë që lidhen me ekzekutimin e projektit (p.sh. mbi bazën e planit operacional) ose që në një mënyrë tjetër të përshtatshme të përcaktojnë këto detaje me shkrim dhe kur është e nevojshme, të përshtatin çdo marrëveshje të tillë që të marrë parasysh zhvillimet e projektit.

4.8 Zbatimi i Marrëveshjes

Lidhur me dispozitat që nuk janë mbuluar nga kjo Marrëveshje, do t'i referohet dispozitave të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Shqipërisë për Bashkëpunimin Teknik, (shihni Shtojcën 1), dhe Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Shqipërisë mbi angazhimet e lidhura me Bashkëpunimin Teknik, (shihni Shtojcën 4 dhe Shtojcën 5), të dyja referuar në fillim të kësaj Marrëveshjeje.

4.8 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rast se lindin mosmarrëveshje ndërmjet palëve, sugjerohet që ato të zgjidhen me anë të negociatave. Në rast se kjo rezulton pa sukses, do të ndiqet komunikimi përmes rrugëve diplomatike.

4.10 Hyrja në fuqi, kopjet

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e njoftimit të palës shqiptare për përfundimin e procedurave të brendshme ligjore. Ajo do të hartohet në katër kopje origjinale: dy kopje në gjuhën angleze dhe dy kopje në gjuhën shqipe. Në rast mosmarrëveshjeje lidhur me interpretimin e tekstit, versioni në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Tiranë, Maj 2023

Frida Krifca

Ministre e Bujqësisë & Zhvillimit Rural

Tiranë, Maj 2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL TIRANË

Dr. Sonja Kurz

Drejtore e GIZ-it në Shqipëri